

ZEJET E ARMËPUNUESVE DHE E THIKËPUNUESVE

Zejet e armëpunuesve dhe të thikëpunuesve të Prizreni kanë qenë të famshme gjatë shekujve. Pushkët, shpatat dhe brisqet punoheshin me teknikën e rrahjes, derdhjes, gravurës, savatit, filigranit e granulimit. Pushkët, shpatat dhe brisqet janë prodhuar kryesisht në shekullin XVIII e XIX. Sot zeja e armëpunuesve nuk vepron më, ndërsa zeja e brisqëpunuesve është në zhdukje e sipër.

GUNSMITH AND CUTLERY CRAFTS'

The crafts' of gunsmith and cutlery of Prizren were famous during the centuries. Guns, swords and knives were made by forging, smelting, chiseling "savat" polishing, filigree and granulate technique. The guns, swords and knives were decorated with gold and silver. Regarding the old age of long weapons /rifles/ and pistols, they were produced mostly during the XVIII and the XIX century. Today the gunsmith craft has stopped functioning, while the cutlers craft is vanishing day by day.



Fragment i shpatës së familjes së Ymer Prizrenit, Prizren
Fragment of Ymer Prizreni's family sword, Prizren

ZEJA E TERZINJVE

Terzinjtë e Prizrenit, Rahovecit dhe të Suharekës punonin veshje kombëtare: fëstana të gjatë "dollama", mitanë, xhamadanë, këmisha etj. prej kadifesë apo mëndafshi. Veshjet qëndiseshin me fije ari, argjendi ose mëndafshi. Ata punonin sidomos për klasën e lartë shoqërore. Sikur zejet tjera, dyqanet e terzinjve kishin lagjen e vet.

TAILORS' CRAFT

Tailors' of Prizren, Rahovec and Suhareka worked the national costumes: long gowns "dollama", waistcoats, vests, shirts etc. from the velvet or silk. The costumes were embroidered with gold, silver and silk fibers. They worked especially for the high-class society. Like other crafts, the tailors' shops had their own quarter.

Xhamadan gruaje, Zym
Woman waistcoat, Zym



Veshje kombëtare e burrave, Suharekë
Mens' national costume, Suhareka



ZEJA E KAZANXHIVE

Në fillim të shekullit XX, në Prizren ka pasë shumë shitore të zejes së kazanxhive. Ata punonin enë bakri, legenë e ibrikë, kusi të vogla dhe të mëdha, tepsi, sini, mangallë etj, me teknikën e "savatit" dhe të rrahjes. Prodhimet prej bakri nuk përdoren më. Këto prodhime sot nuk mundë të gjenden në shtëpitë e Prizrenit. Zeja e kazanxhinjve në Prizren është shuar. Deri vonë kazanxhitë punonin vetëm në një dyqan.

COOPERSMITH CRAFT

In the beginning of the XX-th century, In Prizren there were many shops of coopersmith craft. They worked cooper plates, jug and basins', a small and big ladles', "tepsi", "sini", "mangall" etc. by "savat" and forging technique. Copper products are not used any more. These products cannot be seen in Prizren houses nowadays. Coppersmith crafts have stopped existing in Prizren. Until recently



Enë dhe mangall bakri, Prizren
Cooper plate and "mangall", Prizren



ZEJA E PUNIMIT ARTISTIK TË DRURIT

Në Prizren, Rahovec dhe Suharekë ka pasë shumë drugdhendës të cilët punonin arka druri, kuti dekorative, furka, korniza, ekzemplarë të enterierit të shtëpive etj. Shumë ekzemplarë të enterierit të shtëpive të gdhendura në dru nuk ekzistojnë më si rezultat i rrënimit të shtëpive të vjetra tradicionale. Artizanati i gdhendjes së drurit me duar e vegla të thjeshta dita-ditës po shuhet.

ARTISTIC WOODCARVING CRAFT

In Prizren, Rahovec and Suhareka there were many shops of woodcarvers, which worked wooden cases, decorative boxes, distaffs, frames, interior house items etc. Many examples of interior house woodcarving items do not exist any more as a result of destruction of old traditional houses. Woodcarving artisan processing by mechanical tools is vanishing continuously.



Tavani në xhaminë e Peqanit të Madh, komuna e Suharekës
Ceiling at the Peqani i Madh mosque, municipality of Suhareka




Arkë druri, Rahovec
Wooden case, Rahovec



Ekzemplarë druri, Restoran "Sharr", Prevallë, komuna e Prizrenit
Wooden examples, Restoran "Sharr", Prevallë, Municipality of Prizren



Pitos në oborrin e teqesë Halveti, Rahovec
Pitos at the Halveti Tekke courtyard, Rahovec



Qilim i zbkuruar, rajoni i Suharekës
Ornamented carpet, region of Suhareka

Shpresë Siqeca

ZEJET ARTISTIKE TË PRIZRENIT, RAHOVECIT DHE SUHAREKËS ARTISTIC CRAFTS' OF PRIZREN, RAHOVEC AND SUHAREKA



OJQ /NGO/ "Shtjefën Gjeçovi"
Prizren, 2011

Prizreni ka qenë qytet i zejeve dhe i artizanateve dhe gjurmët e këtyre aktiviteteve sot akoma mundë të shihen. Në Prizren, zejet më të përmendura ishin: zejet e armëtarisë, argjendarisë, brisqëpunuesve, makasxhive, kazanxhive dhe kallajxhive, zejet e tabakëve dhe të saraçëve, zejet e qeleshepunuesve, të terzinjve dhe të kazazëve, zejet e jorganxhive, të abaxhive dhe të mutavxhive, zeja e orëtarëve, zeja e poçarisë etj.

Prizren used to be the city of crafts and handicrafts and the traces of these activities can still be seen today. In Prizren the most distinguished crafts were: the crafts' of gunsmith, silversmith, cutlers, scissor-makers, coopersmith and tinsmith, the crafts' of tanners and saddlers, the crafts' of white woolen cap makers, tailors' and silk processors, the crafts' of quilt makers, woolen gown makers and woolen rug-makers, the craft of watchmakers, the craft of pottery etc.

ZEJA E ARGJENDARISË

Pjesa kryesore e prodhimeve të zejes së argjendarisë në Prizren në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX punohej prej ari dhe argjendi të larë me ar, ndërsa të tjerat ishin prej mesingu, bakri e bronzi.

Për nga vjetërsia, bylyzykët e tipit të mbyllur me disa rende zinxhirësh dhe disa lloje pafta brezi janë punuar në shekullin XVIII e XIX. Qostekët për orë të burrave, stolitë e kokës " takëmi me aski ", unazat dhe bylyzykët prej një e më shumë pjesësh dhe kornizat e pasqyrave janë të fundit të shekullit XIX e të fillimit të shekullit XX. Ndërkaq, punimet më të reja, të fillimit të shekullit XX, janë zinxhirët e burrave, vathët, qaforet e grave, bylyzykët njëpjesësh, dypjesësh e shumëpjesësh të tipit të mbyllur, broshet dhe brezat e argjendta filigranike dhe bylyzykët e brezat "fishekli".

Shumë prodhime të filigranit prizrenas janë shitur jashtë vendit dhe janë ekspozuar në ekspozita dhe muze të ndryshme botërore, si p.sh. në Ekspozitën Universale në Paris në 1867, ekspozitën në Londër në 1866 etj.

Një numër të stolive prizrenase dhe veglat complete të kësaj zeje ne mund t`i gjejmë në disa muzeume. Një numër stolish ndodhen në koleksione private në Prizren, në qytete bregdetare të Kroacisë dhe kudo ku jetojnë aktualisht familjet katolike prizrenase. Këto koleksione private duhet të hulumtohen në të ardhmen, për të formuar një historik më të plotë për argjendarinë prizrenase.

Sot zeja e argjendarisë vepron në më se 50 shitore private. Në këto shitore ne mundë të shohim ose të blejmë ndonjë prodhim të vjetër, të punuar para 50-60 vitesh kryesisht për regjionin e Hasit të Prizrenit dhe fshatrat e tjera përreth qytetit. Sot argjendarët punojnë modele të reja prej ari e argjendi, në përshtatje me kërkesat e reja të blerësve. Veç shitoreve private, prodhimet e argjendarisë punohen në fabrikën "Filigran" e cila është themeluar në vitin 1946. Aty prodhojnë jataganë, brisqe, frutore, shandanë, stoli që imitojnë anijet, vazot, xhamitë dhe motive të tjera sipas porosisë.

Prodhimet e argjendarisë prizrenase kanë vlera të veçanta historike dhe etnologjike. Ato sjellin imazhin e një mjeshtërie të përkryer artistike, ekzemplarët e së cilës edhe sot e kësaj dite numërohen ndër antikuare të rralla, me rëndësi të veçantë.

MJESHTËRIA E ENDJES DHE QËNDISJET NË TEKSTILET PRIZRENASE

Mjeshtria e punimit të mëndafshit dhe të pambukut në Prizren ishte një traditë e njohur e artizanatit shtëpiak. Penj prej mëndafshi dhe pambuku të Prizrenit, janë shitur madje edhe në Dubrovnik /Kroaci/.

Shumë vajza dhe gra nëpër shtëpi endnin dhe i qëndisnin pëlhurat e mëndafshita dhe të pambukta. Në vitin 1920/21, në Prizren ka ekzistuar shkolla zejtare pesëvjeçare për femra, e cila i ka aftësuar vajzat për punëdore. Këto punime në përgjithësi u takonin shtresave të pasura qytetare. I punonin kryesisht vajzat e fejuara për pajë.

Në anët e këmishëve të burrave dhe të grave dhe në anët e rizave të kokës së grave përdorehin oja të bëra me gjilpërë. Ndërkaq, mesi i mëngëve të këmishëve, përparëset, rizat e dorës, tekstilet e interierit, ato rreth ngrënies dhe fjetjes, qëndiseshin me fije ari, argjendi e mëndafshi shumëngjyrësh. Disa prej objekteve gjatë endjes zbukuroheshin me material të njëjtë, por me ngjyrë tjetër dhe me vija me trashësi të ndryshme. Bllloqet tjera pas endjes qëndiseshin me teknikën e mbushjes.

Disa objekte qëndiseshin me fije ari, ndërsa të tjerat me kombinimin e fijos së arit dhe të argjendit me fije të mëndafshit. Zbukurimet punoheshin me gjilpërë në gjergjef, me teknikën e mbushjes, me kryqa, gjysmëkryqa, "toledo" dhe azhur. Në ndonjëren gjejmë kombinimin e teknikës me mbushje, me gjysmëkryqa dhe azhur ose me mbushje dhe "toledo ". Këto objekte kishin kryesisht stolisje të natyrës florale. Vajzat dhe gratë modellet i krijonin vetë, duke u bazuar kryesisht në formën natyrore të luleve e të fletëve të tyre /trëndafili, lala, vjollca, zymbyli e karafili/. Zbukurimet gjeometrike ishin në formë të rrumbullakët, trekëndëshi, katrori e katërkëndëshi e rombi të imët në formë rrjete etj.Ndër motivet zoomorfe pëlqeheshin zogjtë, gjarpërinjtë e pallojtë në formë natyrore ose të skematizuar. Pjesa dërmuese e tekstileve prej mëndafshi ruhen nëpër shtëpi privto trashëgohen brez pas brezi dhe përdoren edhe sot e kësaj dite në raste të shënuara gazmendi e pikëllimi.

SILVERSMITH CRAFT

During the XIX and the beginning of the XX century, most of silversmith products in Prizren, were mainly made of gold and gilt silver, and others were made of bronze and cooper.

Regarding the old age of bracelets with several rows of chains and some other products called "pafta", they were produced during the XVIII and the XIX century. Chains and pocket watch chains for men, head jewelry called "takëmi me aski" /table-sets with straps/, rings and bracelets made of one or more ornamented parts, while mirror frames were made by the end of XIX and the beginning of the XX century. The twentieth century is presented with new products like: pendants, ear rings, bracelets consisted of one or more parts, brooches, silver filigree belts, bracelets and belts called "fishekli", etc.

Most of filigree products from Prizren were sold out of the country and they were presented in many different exhibitions and museums round the world, for example at Universal Exhibition in Paris in 1867, Exhibition in London in 1866 etc.

A part of Prizren jewelry and tool kits of this craft can be still found in several museums. Other parts remain as private collections in Prizren and in coastal towns in Croatia or other places where catholic families from Prizren are settled. Regarding private collections, a further study should be made in the future aiming to establish better background of silversmith craft in Prizren.

Today silversmith craft can still be seen at about 50 private shops. In these shops you can find or buy an old product dating from 50-60 years with motives of region of Has of Prizren or other villages of Prizren neighborhood.

Today the silversmiths make new products of silver and gold, as ordered by new costumers. Besides private shops, the silversmith products are also made in Filigree factory, established in 1946. They mainly produce silver knives, candlesticks, chip jewelry, vases, mosques and other motives depending on costumers' orders.

Silversmith products of Prizren have particular historical and ethnological value. They bring the image of skilful technique, while its samples are considered as rare antiques of its kind.



Bylyzyk argjendi, Prizren
Silver bracelet, Prizren



Filigrani prizrenas
Prizren filigree



Gjerdan dhe vathë femrash, Zym, rajoni i Hasit të Prizrenit
Female's necklace and earrings, Zym, region of Has of Prizren



WEAVING HANDICRAFT AND EMBROIDERY OF PRIZREN TEXTILE

The skillful technique of silk and cotton manufacturing in Prizren was famous for its traditional homemade artisan. Silk and cotton fiber from Prizren were sold even in Dubrovnik /Croatia/.

Silk and cotton fiber was woven by many wives and young girls in their houses. In 1920, a five-year girls school was established in Prizren to teach young girls and women this handicraft. Almost all of the works belonged to the upper class, dedicated for the betrothed girls who were preparing for their dowry.

Thread needlepoint laces were used on shirt-hems for men and women, and women head kerchief-hems. Shirt mid-sleeves, aprons, handkerchiefs, table clothes, and bedspreads were embroidered by different colors of gold and silver threads. Some of the scrollwork was done with a same material but different colors and different thick lines. After the weaving another clocks were embroidered by filling technique.


Some of the objects were embroidered with golden thread, whereas the others by combination of gold silver and silk thread.Embroidery ornaments were done with needles on the loom, by filling technique, cross-stitched, half-cross stitched, hem-stitched, Toledo, etc.

Floral motives, which mainly dominated in these objects, were taken from different flower leaves and shapes in the nature such as: rose, carnation, violet, lilac, daffodil, etc. Geometrical motives were presented in different shapes such as: circle, triangle, square, rhomboid net shape, etc. Preferable animal motives like those of birds, snakes, and peacocks, were presented in their natural or schematic shape.

Most of the weaving handicraft is still preserved in private houses. It is kept and inherited from generation to generation, and we can still see it in occasions of merriments and sorrow.



Përparëse gruaje, varianti katolik, Prizren
Woman apron, Catholic version, Prizren



Përparëse gruaje, varianti mysliman, Gjonaj,
rajoni i Hasit të Prizrenit
Woman apron, Moslem version, Gjonaj, region
of Has of Prizren



Dy tekstile zbukurues muri, Prizren
Two ornamented wall textiles, Prizren

